

VENDIM
Nr.66, datë 21.10.2010

PËR NDËRTIMIN E KOMPLEKSIT TË RI PARLAMENTAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar në vendin ku ndodhet Qendra Ndërkombëtare e Kulturës “Pjetër Arbnori” në Tiranë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet, si aneksi 1 këtij vendimi.

II. Projekti i Kompleksit të ri Parlamentar realizohet me anë të konkursit ndërkombëtar, me ftesë për marrje pjesë studiove më të njohura ndërkombëtare, sipas detyrës së projektimit që i bashkëlidhet, si aneksi 2 këtij vendimi.

III. Vlerësimi i projekteve të paraqitura kryhet nga një juri ndërkombëtare, e përbërë prej pesë arkitektësh të shquar, vendas dhe të huaj.

IV. Destinacioni i ndryshuar i sheshit të parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi dhe procedura që do të ndiqet për ndërtimin e Kompleksit të ri Parlamentar përcaktohen me ligj të veçantë të Kuvendit.

V. Për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi dhe akteve të tjera ligjore krijohet një komision shtetëror i përbërë nga:

- Kryetari i Kuvendit,
- Kryeministri,
- Ministri i Punëve Publike dhe Transporteve,
- Ministri i Financave,
- Kryetari i Bashkisë së Tiranës,
- Dy kryetarët e grupeve më të mëdha parlamentare në Kuvend,
- Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Komisioni Shtetëror, brenda 7 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, përcakton studiot e njohura ndërkombëtare, që u dërgohet ftesa për marrje pjesë, si dhe miraton Rregulloren e Organizimit të Konkursit Ndërkombëtar.

VI. Për realizimin e kësaj faze të ndërtimit të Kompleksit të ri Parlamentar, Kuvendi përdor një fond të ndarë sipas zërave në aneksin 3 të këtij vendimi.

VII. Pranë Kuvendit të Shqipërisë ngrihet Njësia Teknike e Ndihmës dhe Asistencës për realizimin e Kompleksit të ri Parlamentar. Përbërja e Njesisë përcaktohet me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit.

VIII. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit të sigurojë ndihmën dhe asistencën për realizimin e këtij projekti.

IX. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)